



Nr. i Protokollit

02-07/2-315/1

Data

26.03.2026

Në bazë të dispozitave të Rregullore Nr. i Protokollit: 01-143/2, datë 10 Shkurt 2026, Për Procedurat e Punësimit dhe Menaxhimit të Marrëdhënies së Punës<sup>1</sup> në Ndërmarrjen Publike Banesore SHA Prishtinë, Vendimit Nr. i Protokollit: 02-07/261/1, datë 09 Mars 2026, të Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Banesore SHA Prishtinë, për Shpalljen e Konkursit për një (1) pozitë pune Inxhinier/e Mbikëqyrës/e dhe Projektues/e në Punët e Instalimeve të Elektrikës, si dhe Vendimit Nr. Protokollit: 02-07/261/3, datë 11 Mars 2026, të Kryeshefit Ekzekutiv për emërimin e Komisionit Përzgjedhës sipas Shpalljes Publike të Konkursit me datë 09 Mars 2026, Komisioni Përzgjedhës, mori këtë:

### V E N D I M

1. Ndërpritet Procedura e Rekrutimit për një (1) pozitë pune: Inxhinier/e Mbikëqyrës/e dhe Projektues/e në Punët e Instalimeve të Elektrikës e shpallur me datë 09 Mars 2026.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m

Kryeshefi Ekzekutiv i NPB SHA Prishtinë sipas kërkesës së njesisë kërkuese Departamenti i Planifikimit, Projektimit dhe Mbikëqyrjes, ka miratuar me Vendimin Nr. i Protokollit: 02-07/261/1, datë 09 Mars 2026, Shpalljen e Konkursit për një (1) pozitë pune Inxhinier/e Mbikëqyrës/e dhe Projektues/e në Punët e Instalimeve të Elektrikës dhe po ashtu me Vendimin Nr. Protokollit: 02-07/261/3, datë 11 Mars 2026, Kryeshefi Ekzekutiv ka emëruar Komisionin Përzgjedhës, sipas shpalljes publike të konkursit respektiv.

Pas kalimit të afatit të dorëzimit të aplikimeve, nga data 09-23 Mars 2026, Komisioni Përzgjedhës, me datë 26 Mars 2026, është njoftuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, se nuk ka asnjë aplikim, andaj, në bazë të mungesës së aplikimeve, Komisioni i Rekrutimit, vendosi që të bëjë ndërprerjen e kësaj procedure rekrutimi dhe të njoftojë Kryeshefin Ekzekutiv.

### K O M I S I O N I I R E K R U T I M I T

Znj. Albana BERISHA – Kryetare e Komisionit

Znj. Tebare GASHI – Anëtare

Z. Premton BASHOTA – Anëtar



### Të administrohet:

-Divizionit i Burimeve Njerëzore.

<sup>1</sup> Me nr. Protokollit: 01-592/1, datë 29 Mars 2023.